



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
KQSHM

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY
DVSM

TESTI I MATURËS

ARSIMI PROFESIONAL III
(ADMINISTRATË, EKONOMI, ADMINISTRIM BIZNESI,
HOTELERI, TURIZËM)



Prishtinë, gusht 2009

Emri dhe mbiemri i nxënësit


Shkolla.....

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t'u përgjigjeni 100 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t'u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

"Gjergjit shqiptar, shëndet!

Do të ishte punë më e hijshme për ty si luftëtar i dëgjuar t'i ndiqje deri në fund turqit, për hir të dashurisë për fenë e krishtere nëse ke, dhe jo kështu si vepron ti tashti, që lë vendin tënd dhe hidhesh në Itali për të luftuar me ne të krishterët që jemi vëllezërit tu vetëm në fe, (nëse jemi pasi ti e ndërron fenë sa herë të të pëlqejë!!) Ti e quan veten luftëtar të pa thyeshëm e na je hedhur neve sipër që me plot të drejtë quhemi nga populli si të krishterë të vërtetë. Kur erdhe këtu, mos ke kujtuar se do të luftoje me turqit? Ne jemi tjetër fis. Jemi njerëz me tradita të pasura e të fisëm e jo si ju shqiptarët apo turqit.

Mbase nuk munde dot të shpëtosh shtëpinë tënde nga turqit, mendove të pushtosh shtëpinë e huaj. U gënjeve, këtu në vend të shtëpisë do të gjesh varrin tënd o Gjergj!

1. Fragmenti mbizotërohet nga diskursi:

- A. religjioz
- B. historik
- C. politik
- D. letrar

2. Ironia shprehet në fjalinë:

- A. ti e quan veten luftëtar të pathyeshëm e na je hedhur sipër
- B. kur ke ardhur këtu, mos ke kujtuar se do të luftoje me turqit
- C. u gënjeve, këtu në vend të shtëpisë do të gjesh varrin o Gjergj
- D. jemi njerëz me tradita të pasura e jo si ju shqiptarët apo turqit

3. Periudha: "Do të ishte punë më e hijshme për ty si luftëtar i dëgjuar t'i ndiqje deri në fund turqit", shpreh marrëdhënie:

- A. kushtore
- B. lejore
- C. shkakore
- D. kundërshtore

Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Kosova nuk ka shumë alternativa sa i përket zhvillimit ekonomik dhe ofertës për investitorët e jashtëm. Promotorë të këtyre proceseve mund të jenë energjetika dhe xehetaria. Sado që ende ka vlerësime romantike se "Kosova mund ta mbajë vetveten", megjithatë mundësitë janë shumë të kufizuara. Ato ndërlidhen me resurset, por edhe me mungesën e zgjidhjeve për valorizimin e tyre. Moskompletimi i spektrit ligjor dhe futja e pakontrolluar e konkurrencës nga importi, nxjerrin edhe dilemën se sa ia vlen të investohet në Kosovë. Sado që është një pyetje pesimiste, ajo nuk është larg realitetit tonë.

(Marrë dhe përshtatur nga gazeta *Express*)

4. Nga teksti i dhënë më lart del se ekonomia e Kosovës:

- A. Nuk ka resurse të mjaftueshme energjetike
- B. Mund të mbështetet në spektrin aktual ligjor
- C. Nuk është atraktive për investuesit e huaj
- D. Mund të mbështetet në energjetikë dhe xehetari

5. Informata themelore që nxirret nga ky fragment është:
- A. Mungojnë zgjidhjet për valorizimin e resurseve
 - B. Energjetika dhe xehetaria janë atraktive për investuesit
 - C. Spektri ligjor ofron mundësi të mira për investuesit
 - D. Kosova e mban vetveten me energjetikë dhe miniera
6. Periudha: *"Kosova nuk ka shumë alternativa sa i përket zhvillimit ekonomik"* në kohën më se të kryer të mënyrës habitore bën:
- A. Kosova nuk paska shumë alternativa sa i përket zhvillimit ekonomik
 - B. Kosova nuk paskësh shumë alternativa sa i përket zhvillimit ekonomik
 - C. Kosova nuk paska pasur shumë alternativa sa i përket zhvillimit ekonomik
 - D. Kosova nuk paskësh pasur shumë alternativa sa i përket zhvillimit ekonomik
7. Fjalinë: *Të zbatohet detyrimisht në medie norma e gjuhës letrare kombëtare sipas drejtshkrimit të njësuar*, e bën urdhërore fjala a formanti:
- A. në
 - B. të
 - C. zbatohet
 - D. norma

Lexo paragrafin e dhënë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Ai vetëm një dhembje nuk duronte dot: dhembjen për motrën e dashur të varrosur së gjalli pranë tij, në kullën e lartë, që t'ia mjekonte plagët, të përkujdesej për të.

8. Mbështetur mbi këtë paragraf, ju mund të identifikoni (kontekstin) rrethanat se fjala është për:
- A. motrën e Kostandinit
 - B. motrën e Halil Garrisë
 - C. motrën e Gjergj Elez Alisë
 - D. motrën e Mujit e Halilit
9. Virtyti kryesor që nxirret në pah në këtë paragraf është:
- A. Mirënjohja e vëllait për motrën e përkushtuar
 - B. Përballimi i dhimbjes që shkaktonin plagët
 - C. Dashuria e motrës për vëllanë e sëmurë
 - D. Përkushtimi i motrës ndaj vëllait të sëmurë

Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Nuk do ta merrja këtë libër tepër seriozisht. Kjo nuk është një përpjekje për të zgjidhur një pe në një ballkanike; nuk është studim për popujt primitivë; nuk është kontribut për dijet njerëzore dhe shpresoj se asnjëri nuk do ta lexojë për ta përmirësuar trurin e vet. Kjo duhet të lexohet ashtu siç janë përjetuar aventurat në të, me një ngarendje të hareshme të mendjes, me një shije për popujt e huaj dhe shtigje të panjohura dhe me një kënaqësi për të papriturën.

Këtu po u jap vetëm atë që kam parë, ndier dhe sidomos që kam mësuar në baritjet në mesin e fiseve në brendi të maleve veriore shqiptare. Madje, kjo nuk është as e tërë Shqipëria, ai vend i vogël, tepër i vogël edhe për ta gjetur edhe në hartë. Ky nuk është pos një fragment i kësaj bote të gjerë, tjetërfare dhe romantike, që ua sjell me vete një shtegtare atyre që rrinë në shtëpi.

R. W. L. (Rouz Uajlder Lein “*Majat e Shalës*”)

10. Cila nga fjalitë e këtij teksti shpreh më së miri zhanrin të cilit i takon ky libër?

- A. ky është një fragment i kësaj bote, që ua sjell me vete atyre që rrinë në shtëpi
- B. këtu po u jap vetëm atë që kam parë, ndier dhe sidomos që kam mësuar
- C. kjo nuk është as e tërë Shqipëria, ai vend i vogël, tepër i vogël
- D. ky nuk është pos një fragment i kësaj bote të gjerë, tjetërfare dhe romantike

11. Në aspektin kompozicional, fragmenti i shkëputur mund të vendoset:

- A. vetëm në fund të librit
- B. vetëm në mes të librit
- C. vetëm në fillim të librit
- D. qoftë në fillim qoftë në fund

Lexo poezinë e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Le mbas vetes Detin, Malin, Tokën, Fushën,
E shtëpisë së moçme i vë dry në derë
Me litar shpëtimi prapë e lidhe gushën
Frymën zënë që pate e hudhe në erë

I ikur nga dheu nis mërgim të ri
Ta gjesh botën tënde që ik diku larg
Nëpër terr të qiellit që të vesh në zi
Ndjek yjet e shpresës të nisur në varg

Me ngulm e ndjek kohën që ik e ik
Ajo të vjen mbas gjurmëve si breshkë
Duke ngrënë veten në fund gjaku pik
I kuq, jo i zverdhur si gjethi në vjeshtë

Këmba doras koha nuk është ti, është rrenë
Nuk do ta thotë lajmin pos qeshjes së kotë
Tash gjurmët e breshkës i ruan një qen
Në qafë i var ndërrimet që bëhen në botë

.....
(Sabri Hamiti, “*Trungu Ilir*”)

12. Në këtë poezi shprehet një ndjesi e rrëfimit lirik për:

- A. largimin
- B. kthimin
- C. zemërimin
- D. përmallimin

13. Vargjet: *Nëpër terr të qiellit që të vesh në zi*
Ndjek yjet e shpresës të nisur në varg,
janë gërshetim i figurës së:

- A. krahasimit dhe hiperbolës
- B. antitezës dhe alegorisë
- C. ironisë dhe personifikimit
- D. metaforës dhe simbolit

14. Kjo poezi është me:

- A. rimë të alternuar dhe varg të matur
- B. rimë të kryqëzuar dhe varg të bardhë
- C. rimë të puthur dhe varg të lirë
- D. rimë të ndërprerë dhe varg të thyer

Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

I.

Terri u derdh, e një rrigë e praruar e rrezëve të hënës e lau kreshtën e malit, luginën dhe u ngrit poshtë, atje mbi syprinën e lëmuar të lumit që rimon buzët dredharake të fushës. Çdo gjë është lidhur e shtrënguar mirë e mirë nga penjtë e qetësisë, nga penjtë e kësaj heshtjeje, e cila është e rëndë, e palëvizshme. Edhe qyqja hesht. As bulku nuk dëgjohej. Çdo gjë është struktur në vetvete, është mbyllur e kyçur në therrën e gjumit.

E lart, atje lart nëpër hapësirën e kupës së qiellit, një yll noton duke lënë mbas vetes një hark të gjatë vezullues.

II

Një klithmë u dëgjua!

Korbi krokati.

E penjtë e qetësisë u prenë si me shpatë.

Lisat e gjatë, që duken si fantazma të trishtueshme, shushuruan. Edhe qyqja kukati tri herë. As bulku nuk mbeti pa lëshuar zë.

Kurse hëna ndali rigën e praruar të rrezeve të veta. Ajo u fsheh mbas një reje me skaje të grisura. Nuk desh të shihte krimin, nuk desh të përlyhej nga pikat e gjakut që i lëshonte prerja e korbit.

Një hije, si hije vdekjeje, kaploi vendin.

(Anton Pashku "Klithma")

15. Cila nga strukturat e fjalisë nis thyerjen e atmosferës në këtë rrëfim?

- A. edhe qyqja hesht
- B. një klithmë u dëgjua
- C. qyqja kukati tri herë
- D. as bulku nuk dëgjohej

16. Përmasa e qetësisë shprehet më së miri me fjalinë:

- A. një rrigë e praruar e rrezëve të hënës e lau kreshtën
- B. ajo u fsheh mbas një reje me skaje të grisura.
- C. edhe qyqja hesht, as bulku nuk dëgjohej
- D. nëpër hapësirën e kupës së qiellit, një yll noton

Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Herodian (lib. 2 Cesarum) shkruen se perëndori Çesar August' dëshëronte fort me pasunë ndër ushtërij të tijnaj t' Arbëneshëtë, përse thoj se pësonjë shumë e nukë druenë për huue për het, e se janë ma zemërorë se të tjerëtë. Posi duketë se bani Leka i madh, Skanderbegu, e 300 Maqedonas kundër panjefunet ushtërij Ksersit. E nd'e vonë (si përsipëri), malësorët tanë, të sijtë kuraj nukë përvihenë ndjerë nd'anët sanxhakëvet, qefalij të nji kaqi t'madhi mizuar, qi ban me djersunë gjithë shekullinë...

(Pjetër Bogdani "Burrëniya e malësorëve")

17. Gjuha e këtij fragmenti i takon:

- A. gegërishtes së shek. XVI
- B. gegërishtes së shek. XVII
- C. toskërishtes së shek. XVI
- D. toskërishtes së shek. XVII

18. Nëse fjalia: "*Posi duketë se bani Leka i madh, e 300 Maqedonas kundër panjefunet ushtërij Ksersit*", kthehet në shqipen e sotme standarde, bën:

- A. Njëjtë veproi Leka i Madh, me 300 maqedonas kundër ushtrisë së panumërt të Ksersit.
- B. Sikur veproi Leka i Madh, me 300 maqedonas kundër ushtrisë së panumërt të Ksersit.
- C. Njëjtë veproi Leka i Madh, me 300 maqedonas kundër ushtrisë së panjohur të Ksersit.
- D. Sikur veproi Leka i Madh, me 300 maqedonas kundër ushtrisë së panjohur të Ksersit.

19. Orientalizmat janë karakteristikë tipike për poezinë e:

- A. Rilindjes
- B. Realizmit
- C. Modernitetit
- D. Bejtëxhinjve

Lexo paragrafin e dhënë dhe përgjigju pyetjes

Kjo vepër ka në epiqendër trimin i cili përjeton peripetitë e panumërta gjatë rrugës duke u kthyer nga lufta e Trojës për në atdhe, peripeci e rreziqe që ia shkakton Poseidoni, Perëndia e Detit, të cilës ky trim ia verboi të birin, prijësin e Qiklopëve.

20. Për cilin nga heronjtë e veprave të Homerit bëhet fjalë?

- A. Hektori
- B. Agamemnoni
- C. Odiseu
- D. Akili

ENGLISH LANGUAGE

21. Choose the correct alternative to complete the following sentence:


The opening ceremony of his exhibition was held on 22/07/2008.

It was held on _____.

- A. the twenty-second of July, two thousand and eight
- B. the twenty-second July, of two thousand and eight
- C. twenty-two July, at two thousand and eight
- D. twenty-second of July, in two thousand and eight

22. This graph shows the business scale of a company during five years period. Look at the chart below and choose the correct sentence:

- A. In 1994 sales fell slightly.
- B. In 1995 there was a sharp fall.
- C. In 1997 business reached the peak of its success.
- D. In the five year period sales showed constant increase.



23. Read the following sentences carefully:

- 1. Come on! It wasn't so bad after all, was it?
- 2. No, never. Too much trouble.
- 3. Yes, but I also remember the cold winter nights and...
- 4. Why? Don't you remember those green fields and the fresh air?
- 5. Have you ever thought of moving to the countryside?

The correct order of sentences to form a dialogue is _____.

- A. 1 2 5 4 3
- B. 5 2 4 3 1
- C. 2 1 4 5 3
- D. 4 3 5 2 1

24. ONLY ONE of the words below CANNOT be used to complete the following paragraph. Which one?

We have always very careful in our behaviour at school. We have never insulted anyone, cheated on tests, or done any mischief. We have always been very _____.

- A. respectful
- B. well-mannered
- C. rude
- D. polite

25. Read the following sentences and then choose a sentence to complete the dialogue:

Barbara: Maria and Philip are getting married.

Becky: _____

Barbara: They're in love, remember?

- A. It isn't very interesting, is it?
- B. And they did not see you?
- C. What a sad story.
- D. This can't be true.

26. In the following dialogue:

Barbara: I have always imagined him differently.

Peter: _____ , but he seems quite a nice guy.

From the following words:

1. So did I
2. Me neither
3. Hopefully
4. Unlikely

Peter should say, **‘So did I.’** because _____.

- A. Peter agrees with Barbara
- B. Peter disagrees with Barbara
- C. Peter hopes he is different
- D. Peter doesn't believe he is different

27. Choose the correct answer to complete the sentence:

I always wanted to have black _____.

- A. hairs
- B. hair
- C. hair's
- D. hairy

28. The sentence: **‘My brother is doing a test right now.’** is in the _____.

- A. Present simple tense
- B. Present perfect tense
- C. Present continuous tense
- D. Present perfect continuous tense

29. Look at the following nouns. One of them **DOES NOT** exist. Which one?

- A. readiness
- B. happiness
- C. business
- D. agreeness

30. Choose the best way to join the following sentences:

We wanted to see him so much.

He was very busy as usual.

- A. We wanted to see him so much but he was very busy as usual.
- B. We wanted to see him so much and she was very busy as usual.
- C. We wanted to see him so much because he was very busy as usual.
- D. We wanted to see him so much so he was very busy as usual.

31. Choose the correct sentence:

- A. Last week I went to see my father to Canada.
- B. Last week I went to my father to see Canada.
- C. Last week I went to Canada to see my father.
- D. Last week I went to see Canada to my father.

32. Look at the words in the box:

like - would - you - I - calling - to - not - for - apologize

The correct combination to form a sentence is:

- A. I would like apologize to for not calling you.
- B. I would like to apologize for not calling you.
- C. I would not to apologize like for calling you.
- D. I would not apologize like to for calling you.

33. Which word is different?

- A. bar
- B. pub
- C. café
- D. shop

34. Read the following sentences and then choose a sentence to complete the dialogue:

I wanted to go for a _____.

You can _____, can't you?

- A. drive
- B. paint
- C. call
- D. write

35. One of the word below **DOES NOT** rhyme with the word **fight**. Which one?

- A. right
- B. bite
- C. fate
- D. ride

36. In the string of words: **whale, dolphin, fish, monkey, shark** the word **monkey** is different because _____.

- A. it is a noun
- B. it is an animal
- C. it lives in the sea
- D. it doesn't live in the sea

37. Read the paragraph carefully:

Mrs Fox is an elderly woman. She was born in 1918. Her hair has turned white now, but she's still got bright blue eyes. She's not very tall. **She doesn't seem to be taller than one meter fifty.** She's wearing a grey dress with a white jacket. It's an old dress, I know, because I've seen her in that dress a number of times. However, it looks very nice on her.


Look at the highlighted part of the text and complete the following sentence:

The author _____.

- A. doesn't know if she is tall or short
- B. doesn't know how tall she is exactly
- C. knows how tall she is exactly
- D. is sure she is not one meter and fifty

38. When you see this sign, you instantly know that _____.

- A. everyone can use the facilities
- B. everyone except the disabled can use the facilities
- C. only disabled can use the facilities
- D. only disabled people cannot use the facilities



39. This sport is very popular in the English speaking world and especially in America. It is known as:

- A. cricket
- B. golf
- C. polo
- D. rugby



40. Read the following paragraph:

Two airplanes are landing on London Heathrow Airport: a Lockheed L1011 with 246 passengers and 3 members of the crew and a Boeing 767 with a crew of 2 and the total of 255 passengers. The total number of people on board of the two planes is _____.

- A. 506
- B. 560
- C. 605
- D. 650


MATEMATIKË

41. Pas thjeshtimit shprehja $A = \frac{x^2 + 3x}{x-1} \cdot \frac{x^2 - 1}{x+3}$ ka formën :

- A. $A = x(x-1)$
- B. $A = x(x+1)$
- C. $A = \frac{2}{x-1}$
- D. $A = \frac{2}{x+1}$


42. Është dhënë diagrami. Cila shprehje i përgjigjet pjesës së hijesuar në diagram ?

- A. $C \setminus (A \cup B)$
- B. $(A \setminus B) \cup (B \cap C)$
- C. $B \setminus (A \cup C)$
- D. $(A \cup C) \setminus B$




43. Është dhënë figurat. Cila është shuma e vektorëve: $\vec{AB} + \vec{AD}$?

- A. $\vec{AB} + \vec{AD} = \vec{DB}$
- B. $\vec{AB} + \vec{AD} = \vec{DC}$
- C. $\vec{AB} + \vec{AD} = \vec{AC}$
- D. $\vec{AB} + \vec{AD} = \vec{BC}$



44. Është dhënë figura. Cila nga shprehjet vijuese paraqet syprinën e figurës?

- A. $a \cdot b$
- B. $a \cdot b - x^2$
- C. $a \cdot b + x^2$
- D. $a + b + x^2 + 2x$




45. Cilat janë zgjidhjet e ekuacionit: $\frac{x+1}{x} - 1 = x$?

- A. $x_1 = -2, x_2 = 2$
- B. $x_1 = -1, x_2 = 1$
- C. $x_1 = -\frac{1}{2}, x_2 = \frac{1}{2}$
- D. $x_1 = -\frac{1}{3}, x_2 = \frac{3}{3}$

46. Është dhënë trapezi kënddrejtë ABCD me kënde të drejta te kulmi B dhe C dhe me brinjë $[AB] = 2 \text{ cm}$, $[BC] = 4 \text{ cm}$ dhe $[CD] = 5 \text{ cm}$. Sa është perimetri i trapezit?

- A. $P = 12 \text{ cm}$
- B. $P = 14 \text{ cm}$
- C. $P = 16 \text{ cm}$
- D. $P = 18 \text{ cm}$



47. Është dhënë funksionit $f(x) = \frac{1}{2}(x^2 - 4)$. Sa është vlera: $2 \cdot f(-2) + 3 \cdot f(0)$?

- A. -6
- B. 6
- C. -8
- D. 8


48. Është dhënë brinja e kubit $a = (x - 1) \text{ cm}$. Në qoftë se brinja e kubit rritet për 1 cm , atëherë sa është syprina e kubit ?

- A. $S = x^2 \text{ cm}^2$
- B. $S = 6x^2 \text{ cm}^2$
- C. $S = (x + 1)^2 \text{ cm}^2$
- D. $S = 6(x + 1)^2 \text{ cm}^2$

49. Në rrethin e dhënë, \overrightarrow{OA} paraqet rrezevektorin e fillimit të këndit $x = \frac{11\pi}{3}$ ku $\pi = 180^\circ$.

Në cilin kuadrant ndodhet rrezevektori i mbarit të këndit x ?

- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV



50. Janë dhënë gjykimet:

$$p: \frac{2}{3} - \frac{5}{4} = \frac{8-15}{7} = \frac{-7}{7} = -1.$$

$$q: \frac{2 + \frac{1}{3}}{1 - \frac{1}{4}} = \frac{28}{9}.$$

$$r: \left. \begin{array}{l} \text{Zgjidhja e sistemi të ekuacionit: } x^2 + y^2 = 0 \\ x - y = 2 \end{array} \right\} \text{ është } x = 2, y = -2.$$

Cili nga pohimet është i saktë ?

- A. Vetëm gjykimi p është i saktë.
- B. Vetëm gjykimi q është i saktë.
- C. Vetëm gjykimi r është i saktë.
- D. Tre gjykimet janë të saktë.

51. Me cilën shprehje është e barabartë shprehja $\frac{2x^5 y^6 z^4}{3xz^7} \cdot 9x^2 y^3 z$?

- A. $6x^6 y^9 z^{-2}$
- B. $6x^6 y^9 z^2$
- C. $\frac{6x^6 y^3}{z^2}$
- D. $\frac{6x^5 y^3}{z^2}$

52. Sa është vlera e x ashtu që mesi aritmetik i numrave : 5, 8, 11, x , 4 të jetë i barabartë me 6 ?

- A. 1
- B. 2
- C. 3
- D. 4

53. Është dhënë numri kompleks $z = (2 + i)^2$, (ku $i = \sqrt{-1}$). Vlera reale $\text{Re}(z)$ është:

- A. $\text{Re}(z) = -3$
- B. $\text{Re}(z) = -4$
- C. $\text{Re}(z) = 3$
- D. $\text{Re}(z) = 4$

54. Cili barazim paraqet probabilitetin e kundërt të ngjarjes A ?

- A. $P(\bar{A}) = \Phi$
- B. $P(\bar{A}) = 1 - P(A)$
- C. $P(\bar{A}) = 1 + P(A)$
- D. $P(\bar{A}) = 1 - P(A)$

55. Është dhënë barazimi $\frac{6 \cdot 8}{18} = 2^a \cdot 3^b$. Sa është shuma $a + b$?

- A. 1
- B. 2
- C. 3
- D. 4

56. Sa korda mund të caktohen me 8 pika në një vije rrethore?

- A. 16
- B. 20
- C. 24
- D. 28

57. Cili nga thyesat e mëposhtme ka vlerë më të madhe për çdo x numër pozitiv ?

- A. $\frac{x+1}{x}$
- B. $\frac{x-1}{x}$
- C. $\frac{x}{x+1}$
- D. $\frac{x+1}{x+2}$

58. Një shitëse lulesh në një panair që zgjati 7 ditë shiti: në ditën e parë 7 lule në ditën e

dytë 12 në ditën e tretë 18 në ditën e katër 25 lule dhe kështu me radhë. Sa lule ajo shiti në ditën e fundit nëse vazhdimisht rritej shitja sipas rregullës së fituar ?

- A. 48
- B. 50
- C. 52
- D. 54

59. Cili jobarazim është i saktë për vlerën e $\sin 100^\circ$?

- A. $-1 < \sin 100^\circ < -\frac{1}{2}$
- B. $\frac{1}{2} < \sin 100^\circ < 1$
- C. $-\frac{1}{2} < \sin 100^\circ < 0$
- D. $0 < \sin 100^\circ < \frac{1}{2}$

60. Ndryshimi i dy numrave është 3, ndërsa prodhimi i tyre është 108. Cilët janë ata numra?

- A. 7 dhe 10
- B. 8 dhe 11
- C. 9 dhe 12
- D. 10 dhe 13

INFORMATIKË

61. Opsioni i zgjedhur në figurë mundëson:

- A. Fillimin e prezantimit
- B. Mbylljen e prezantimit
- C. Përgatitjen e prezantimeve
- D. Përgatitjen e nën prezantimeve


62. Frekuenca e taktit në një mikroprocesor (njësia qendrore e përpunimit të të dhënave-CPU), tregon:

- A. Numrin e operacioneve të cilat fillojnë të ekzekutohen, në njësi të kohës.
- B. Numrin e operacioneve të cilat ekzekutohen, në njësi të kohës.
- C. Numrin e operacioneve të cilat janë planifikuar të ekzekutohen, në njësi të kohës.
- D. Numrin e operacioneve të cilat nuk mund të ekzekutohen, në njësi të kohës.

63. Shkurtesa 'HTTP', është e shpeshtë në fushat e termave të lidhur me Internetin. Në cilën fushë është me rëndësi 'HTTP'?

- A. Gjatë programimit të bazave të dhënave
- B. Gjatë kërkimit të fajllave ndërmjet kompjuterëve
- C. Gjatë leximit të Web faqeve
- D. Gjatë shifrimit të shënimeve

64. Cila pjesë e Web adresës tregon domenin kryesor të Web faqes së paraqitur?



- A. http://
- B. net
- C. www
- D. enlight

65. Funkzionimin e rrjetit Ethernet pa tela , për lidhjen e kompjuterëve mobil, telefonave mobil dhe pajisjeve tjera të dorës, e mundëson:

- A. TCP/IP
- B. H232
- C. HTML
- D. Bluetooth

66. Në bazë të të dhënave në figure, çfarë vlere do të fitohet në celulën F11?

- A. 42
- B. 54
- C. 6
- D. 74

	A	B	C	D	E	F	G
1			Tabela e shpenzimeve Mujore				
2							
3			Shpenzimi			Vlera	
4			Qiraja			300.00 €	
5			Telefoni fiks			42.00 €	
6			Telefoni mobil			54.00 €	
7			Pagesa per uje			6.20 €	
8			Pagesa per rryme			21.50 €	
9			Tjera			74.00 €	
10							
11						= MIN(F4:F6)	
12							

67. Dukuria e ndërlidhjes së dokumenteve ndërmjet veti, në bazë të kuptimeve të caktuara ose në bazë të grupit të fjalëve, quhet :

- A. URL
- B. Hyperlink
- C. TCP/IP
- D. TCP

68. Opsionet: Outlook Today, Calendar, Inbox, Contacts, Tasks, Notes, i takojnë programit,

- A. Google
- B. Yahoo
- C. MS Outlook
- D. MS PowerPoint

69. Sipërfaqja e punës në programin MS Excel përbëhet nga :

- A. Regjistrat
- B. Hapësirat
- C. Fushat
- D. Celulat

70. Prapashtesa e dokumenteve të programit MS Access është :

- A. .mdb
- B. .doc
- C. .ppt
- D. .xcl

EDUKATË QYTETARE

71. Çfarë kanë të përbashkët vrasja dhe rrëmbimi?
- Janë forma të krimit
 - Janë forma të qeverisjes shtetërore
 - Janë forma të komunikimit publik
 - Janë forma të fesë
72. Pushteti i Qeverisjes Shtetërore arrihet përmes tri degëve: legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore. Dega legjislativë ka pushtetin:
- të balancojë punën e qeverisë
 - të nxjerr ligjet e vendit
 - të zbatojë dhe përforcojë ligjet e nxjerra
 - të zgjidh mosmarrëveshjet dhe konfliktet mbi bazën e ligjit
73. Organizime të njerëzve me interesa të përbashkëta që dëshirojnë të ndikojnë në vendimet e qeverisë, por nuk kanë lidhje të drejtpërdrejt me kandidatët e zgjedhur në poste publike quhen:
- emigrantë
 - komunitete
 - grupe të interesit
 - ndërmarrje publike
74. Shërbimet e zjarrfikësve janë përgjegjësi e:
- qeverisjes vendore (lokale)
 - qeverisjes qendrore
 - partive politike
 - komunitetit
75. Nëse një personi të caktuar i mohohet e drejta për mundësi të barabartë për shkak të përkatësisë gjinore, kemi të bëjmë me:
- krim
 - solidaritet
 - stereotip
 - diskriminim
76. **Zëvendësoni vendin bosh me një term adekuat të shënuar me poshtë, që fjalisë së dhënë t'i jep kuptim:**
- _____ janë individë që largohen nga vendi i tyre dhe kërkojnë strehim në vendin tjetër si pasojë e luftës, fatkeqësive natyrore dhe shkaqe të përndjekjes politike.
- Të papunët
 - Refugjatët
 - Emigrantët
 - Ekstremistët
77. Cilën të drejtë përdor personi që e kritikon qeverinë dhe zyrtarët e saj?
- Të drejtën e mendimit të lirë
 - Të drejtën e kritikës së pakufi në demokraci
 - Të drejtën e fyerjes së qeverisë së keqe
 - Të drejtën e fjalës së lirë
78. Edukimi ndërkulturor nënkupton:

- A. ngritjen, zhvillimin dhe avancim e raporteve të qëndrueshme ndërmjet pjesëtarëve të përkatësive të ndryshme në komunitet, dhe konsiderohet çelës që dëshmon shkallën e krimit të një vendi
- B. ngritjen, zhvillimin dhe avancim e raporteve të qëndrueshme ndërmjet pjesëtarëve të përkatësive të njëjta në komunitet, dhe konsiderohet çelës që dëshmon shkallën e arsimimit të një vendi
- C. ngritjen, zhvillimin dhe avancimin e raporteve të qëndrueshme ndërmjet pjesëtarëve të përkatësive të ndryshme në komunitet, dhe konsiderohet çelës që dëshmon shkallën e demokratizimit të një vendi
- D. ngritjen, zhvillimin dhe avancim e raporteve të qëndrueshme ndërmjet pjesëtarëve të përkatësive të njëjta në komunitet, dhe konsiderohet çelës që dëshmon shkallën e varfërisë së një vendi

79. Lexo me kujdes pohimet në vijim:

- I. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës është organ vendimmarrës dhe përbehet nga ministrat e jashtëm të shteteve anëtare.
- II. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës është organ ekzekutiv dhe përbehet nga ministrat e jashtëm të shteteve anëtare.
- III. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës është organ vendimmarrës dhe ekzekutiv dhe përbehet nga ministrat e jashtëm të shteteve anëtare.

Cili nga pohimet është i saktë për Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës?

- A. Vetëm I
- B. Vetëm II
- C. I dhe II
- D. II dhe III

80. Çfarë trajton ligji penal?

- A. Raportet ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve
- B. Marrëdhëniet e personave me shoqërinë dhe shtetin
- C. Marrëdhëniet e individëve me njerëz të tjerë dhe grupe njerëzish
- D. Përcaktimin e parimeve themelore të organizimit praktik të shoqërisë dhe shtetit

81. Gjykata supreme është:

- A. gjykatë themelore e një vendi
- B. gjykatë e shkallës së dytë të një vendi
- C. gjykata më e lartë e një vendi
- D. gjykatë që dëgjon çështjet që përfshijnë fëmijët

82. Si përcaktohet ndarja e pushtetit në republikat parlamentare?

- A. Në bazë të emërimit nga presidenti
- B. Në bazë të emërimit nga mbreti
- C. Në bazë të forcës dhe dijes politike
- D. Në bazë të përqindjes së votave të fituara

83. Cili është qëllimi i Kombeve të Bashkuara?

- A. Ruajtja e paqes në botë, rritja e respektit për të drejtat e njeriut, ngritja e miqësisë mes vendeve, zgjidhja e problemeve të ndryshme ndërkombëtare
- B. Ndërhyrja ushtarake në konfliktin e vendeve të ndryshme nëpër botë dhe dërgimi i trupave ushtarake atje
- C. Hartimi dhe zbatimi i ligjeve sidomos të vendeve në krizë lufte
- D. Qeverisja e botës me ligjet e tyre themelore, në të cilat orientohen ligjet e vendeve të caktuara

84. Cilat janë fushat potenciale integruese në Bashkimin Evropian?

- A. Integrimi religjioz, ideologjik, fetar, ushtarak
- B. Integrimi politik, ekonomik, arsimor, kulturor
- C. Integrimi kulturor, religjioz, etnik, ideologjik
- D. Integrimi etnik, nacional, politik, religjioz

85. Ku qëndron besueshmëria e informacionit në mjetet e informimit (mass media)?

- A. Në atë se sa i lartë është niveli i posedimit të fakteve dhe informacioneve
- B. Në atë se kush është ai që e shpreh informacionin e dhënë në mjete të informimit
- C. Në atë se kush e shpreh i pari informacionin në mjetet e informimit
- D. Në atë se në cilin mjet të informimit përhapet informacioni

EKONOMI ME NDËRRMARRËSI

86. Me çfarë inflacioni kemi të bëjmë nëse çmimet mesatare rriten me norma njëshifrore?

- A. Galopant
- B. Të kostos
- C. Të përmbajtur
- D. Hiperinflacion

87. Kush e tregon sasinë e përgjithshme të mallrave dhe shërbimeve përfundimtare që konsumatorët, firmat dhe qeviria janë të gatshëm të blejnë për çdo nivel të dhënë të çmimeve?

- A. Kërkesa agregate
- B. Oferta agregate
- C. Kërkesa
- D. Oferta

88. Çmimet në konkurrencën monopolistike përcaktohen nga:

- A. kërkesa dhe oferta
- B. firma monopol
- C. ana e shtetit
- D. ndërmjetësuesit financiar në treg

89. Burimet apo faktorët e prodhimit siq janë: toka, puna dhe kapitali janë:

- A. të kufizuar
- B. të pakufizuar
- C. të rritshëm vazhdimisht
- D. të ndryshueshëm për një periudhë të gjatë

90. Çfarë relacioni tregon kurba e kërkesës?

- A. Relacionin ndërmjet faktorëve të prodhimit dhe sasisë së kërkuar
- B. Relacionin ndërmjet sasisë së ofruar dhe sasisë së kërkuar
- C. Relacionin ndërmjet çmimeve dhe sasisë së kërkuar
- D. Relacionin ndërmjet çmimeve dhe sasisë së ofruar


91. Cilat janë qëllimet e politikës monetare në kuadër të ekonomisë nacionale?

- A. Të sigurojë një rritje të qëndrueshme ekonomike, normë të ulët të papunësie, dhe shkallë të lartë të inflacionit
- B. Të sigurojë rritje të produktivitetit të punës, rritje të punësimit dhe një rritje të taksave
- C. Të sigurojë një ulje të normave tatimore, efikasitet të tregut dhe lëvizje të shpejta në ekonomi
- D. Të sigurojë një rritje të qëndrueshme ekonomike, punësim të lartë dhe çmime stabile

92. Ku shprehen kostot ekonomike të papunësië?

- A. Në rënien e GDP – së (rritjen e hendekut të prodhimit)
- B. Në rritjen e GDP – së potenciale
- C. Në zhvlerësimin e kapitalit human, rritjen e kriminalitetit
- D. Në zhvlerësimin e njësisë montare të vendit dhe kriminalitetit

93. Me çfarë strukture të organizimit të menaxhmentit kemi të bëjmë në këtë grafik:



- A. Organizim tekniko-teknologjik të departamenteve
- B. Organizim të thjesht të departamenteve
- C. Organizim divisional të departamenteve
- D. Organizim funksional të departamenteve

94. Sipas ligjit themelor të punës në Kosovë kontratat e punës në mes të punëtorit dhe punëdhënësit mund të lidhen :

- A. vetëm në kohë të caktuar
- B. vetëm në kohë të pacaktuar
- C. në kohë të caktuar dhe të pacaktuar
- D. vetëm në afat prej 10 viteve

95. Çka përfshihet në përpilimin – hartimin e bilancit të gjendjës?

- A. Të hyrat, shpenzimet dhe pasuria
- B. Pasuria, detyrimet dhe kapitali
- C. Shpenzimet e shitjes, kapitali dhe detyrimet
- D. Të hyrat nga shitja, parapagimet dhe keshi

- 96.** Cilët janë faktorët të cilët ndikojnë në përcaktimin e lokacionit të ndërmarrjes në kuptimin e gjërë:
- A. Faktorët e mbrojtjes, të ambientit dhe strategjisë së zhvillimit të ndërmarrjes
 - B. Faktorët e zhvillimit teknik, teknologjik dhe organizativ të ndërmarrjes
 - C. Faktorët e natyrës menaxhuese, kreative dhe teknike të ndërmarrjes
 - D. Faktorët e natyrës objektive, subjektive dhe faktorët ekonomik të ndërmarrjes
- 97.** Ndërmarrjet publike në Kosovë i qeverisin apo administrojnë:
- A. kolektivet punonjëse dhe organet përfaqësuese të tyre
 - B. organizatat politike dhe joqeveritare
 - C. organet e qendrore dhe lokale të shtetit
 - D. organizatat ekonomike dhe asociacionet e tjera ekonomike
- 98.** Me rregullim (ekonomi të dirigjuar) kuptojmë sistemin ekonomik të një vendi ku mjetet e prodhimit, shpërndarja e tyre si dhe përcaktimi i çmimeve bëhet nga:
- A. nga forcat e tregut (kerkesa dhe oferta)
 - B. nga ndërmjetësuesit financiar në treg
 - C. nga tregtarët të cilët janë të pranishëm në treg
 - D. nga një organizëm qendrorë planifikues (shteti)
- 99.** Nëse shteti është në deficit buxhetor, dhe ky deficit nuk mund të mbulohet me të hyra të rregullta, atëherë njëra nga metodat të cilat shteti përdor për të mbuluar këtë deficit është:
- A. zvogëlimi i doganave dhe rritja e akcizave
 - B. marrja e kredive në vend dhe boten e jashtme
 - C. dhënja e kredive botës së jashtme
 - D. zvogëlimi i tatimeve dhe rritja e taksave
- 100.** Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave përfshinë:
- A. eksportin dhe importin e mallrave ndërmjet dy apo më shumë vendeve
 - B. eksportin dhe importin e letrave me vlerë ndërmjet dy apo më shumë vendeve
 - C. këmbimin e valutave ndërmjet dy apo më shumë vendeve
 - D. të gjitha huamarrjet dhe huadhënjet ndërmjet dy apo më shumë vendeve